



# LAJMËTARI I RADIO MARISË



Organ i Radio Marisë Viti I, Nr. 3. Mars 2009

## EDITORIAL

Të dashur miq, ditët po kalojnë me shpejtësi të madhe njëra pas tjetrës. Aty ku punohet koha fluturon dhe njeriu ka dëshirë ta ndalojë ecjen e kohës, por kjo nuk është e mundur. Kështu na ndodh të gjithëve që punojmë në Radio Mari, punët dhe angazhimet e shumta na e bëjnë kohën të shkurtër.

Familja e Radio Marisë në Shqipëri muajin e kaluar pati kënaqësinë ta presë për vizitë Presidentin e Familjes botërore të Radio Marisë, Zotëri Emanuele Ferrarion. Ja porositë që na i dha. Ai tha:

«Në të gjitha radiot në botë gjej vullnetarë por këtu në Shqipëri, vullnetarët e radios janë të rinj, më të rinjtë në botë, dhe çdo herë që vij ndjej një gëzim të veçantë. Një meritë të veçantë për këtë e ka edhe don Preka. Radio Maria në Shqipëri, është një mrekulli, të cilës dëgjuesit e saj i kanë dhënë një ndihmë të madhe, sepse është shndërruar në dashuri për ta. Unë këtu shoh një të ardhme të madhe, sepse Radio Maria po i ndihmon shumë njerëzit dhe Don Preka e ka dhënë vetveten për këtë gjë, dhe nëse ne tashmë rrezikojmë, rrezikojmë pikërisht për këtë gjë.

Më pëlqen ajo që tha don Preka, se Radio Maria në Shqipëri është radio e hapur të cilën kanë mundësi ta vizitojnë, dhe e vizitojnë çdo ditë dëgjuesit e saj, sepse kjo tregon dashurinë e madhe të cilën ata e kanë për Radio Marinë. Dëgjuesit këtu me siguri i përngjajnë një dëgjueseje të Radio Marisë e cila së pari e ndihmoi Radio Marinë që të mos mbyllet, pastaj pse ndjente se Radio Maria po i jepte personalisht asaj diçka dhe në fund e ndihmon për çdo muaj që Radio Marina të rritet. Jam i bindur se këtë gjë e bëjnë edhe dëgjuesit e Radio Marisë në Shqipëri.

Sot Radio Maria është e shpërndarë në 5 kontinente. Në Afrikë kemi dëgjueshmëri shumë të madhe. Atje njerëzit janë shumë, shumë të varfër, por prapëseprapë ata gjejnë mënyrën që nga skamja e tyre ta ndihmojnë Radio Marinë. Kemi disa vende ku dëgjuesit arrijnë shtatë deri në tetë milion në ditë dhe atje Radio Maria i përgjigjet vullnetit të saj sepse kemi shumë dhurues dhe mbështetës të saj. Në pjesën më të madhe të vendeve ku ka lindur Radio Maria ajo është radio kombëtare. Ne nuk mund të themi se jemi Radio, sepse të gjithë që punojmë në Radio Mari gjatë gjithë kohës së punës që bëjmë jemi në shërbim të dëgjuesve tanë. Marrim te holla nga njerëzit që na i dhurojnë dhe ndihmojmë radiot më të varfra. Në Afrikë radio Maria është radio numër dy, pas Radios shtetërore. Jemi të vetëdijshëm se

Në këtë numër do të gjeni:

-Editorial	fq. 1
-Veprimtaritë e Radio Marisë	fq. 2
-Këndi i fëmijëve	fq. 2
-Libri "Pali i Tarsit..."	fq. 3
-Një javë me vullnetarët në Kosovë	fq. 3
-Si të jemi mirënjohës	fq. 4
-Si mund të ndihmoni Radio Marinë	fq. 4
-Lurdi 1858 – 2008	fq. 4
-Viti i Shën Palit 29.06 .08– 29.06.2009	fq. 4

te hollat gjithmonë na mungojnë për të çuar përpara projektin e Radio Marisë në botë, prandaj kemi menduar se për këtë gjë duhet t'i drejtohem Marisë që Ajo të kujdeset.

Kohën e fundit kemi hapur një Radio në Indonezi ku kemi hasur në vështirësi të mëdha të cilat i kemi tejkaluar dhe tashmë transmetojmë për popullin vendas. Na u desh të jemi shumë të urtë, të bëjmë zgjedhje të mëdha... Kjo do të thotë se Maria është e urtë dhe i planifikon të gjitha për fëmijët e saj.

Sipas vullnetit që kanë dëgjuesit, Radio Maria çdo vit hapet edhe në katër vende të reja. Gjatë këtij viti planifikojmë hapjen e saj edhe në dy vende të reja, përfshi këtu edhe Ukrainën. Unë personalisht në Radio Mari nuk jam asgjë tjetër përveçse një president që kryen shërbimin, sepse Presidentja e vërtetë e Radio Marisë është Zoja e bekuar. Shën Maksimilian Kolbe, pajtori i mediave pat thënë: «Në vitet e ardhshme do të hapet një radio, sipas mendimit tim këtë duhet ta bëjmë ne françeskanët, por nëse nuk e bëjmë ne, Zoja do të gjej dikën tjetër që ta bëjë!» Unë nuk dua të them se këtë profeci sot e kemi plotësuar ne!

Radio Maria shkon vetëm në ato vende ku jemi të ftuar, dhe kudo që kemi shkuar gjithmonë kemi gjetur njerëz më zemër të madhe që janë vënë në shërbim të Radio Marisë. Ne jemi një projekt i vogël, por Zoja ka një projekt të madh dhe besoj se një ditë Radio Maria do të dëgjohet edhe në Arabinë Saudite. Në Uruguai njerëzit janë tepër të shekullarizuar, kanë arritur në atë gjendje sa që gjatë një procesioni filluan ta gjuajnë Të Shenjtërueshmin Sakrament me vezë. Besoj se ka kuptim t'i ndihmojmë këta njerëz që përsëri ta gjejnë Zotin. Por vërtetë ne nuk jemi asgjë, jemi pak më shumë se gomari i cili mbart peshën që i është ngarkuar. Është një nder shumë i madh për Radio Marinë që krahas shërbimit që bënë për dëgjuesit tjerë është radio që i ka zgjedhur të sëmuret, të vetmuarit..., si të zgjedhur të saj duke e ushqyer në ta secilën ditë shpresën, prandaj ata e ndjejnë nevojën që ta mbështesin.

Ju duhet të jeni të vetëdijshëm se gjithmonë duhet të rriteni dhe të mësoni, sepse të bëjmë diçka për Radio Marinë do të thotë ta bëjmë këtë gjë me përvujtëri të plotë, sepse projekti i Radio Marisë këtu në Shqipëri është që edhe atje ku është vetëm një shqiptar të arrij zëri i Radio Marisë. Edhe pranë të gjitha sukseseve që kemi duhet të ecim me këmbë për tokë dhe të mos ndalemi kurrë, sepse nëse Coca-cola ka shije tjetër në Amerikë e shije tjetër në vendet e tjera, Radio Maria e ka të njëjtën shije të dashurisë për dëgjuesit e saj në të gjitha vendet e botës. Radio Maria i përket të gjithë njerëzve dhe jo vetëm katolikëve prandaj neve na duhet të jemi misionarë që t'i shoqërojmë njerëzit deri në Kishë, deri tek Zoti».

Emanuela Trasha

NË INTERNET E DËGJONI RM NË:

[www.radiomaria.org.al](http://www.radiomaria.org.al)

Çdo ditë në Orën 14.00 e lusim bashkë

Udhën e kryqit për nëvojat tuaja

## Veprimtaritë e Radio Marisë Shqiptare

Fillimi i vitit 2009 për Radio Marinë Shqiptare premtion shumë dhe për këtë e falënderojme Hyjin.

Të drejtuar nga Zoja e Bekuar, instrument i të cilës është Radio Maria, stafi i saj të bashkuar në lutje me dëgjuesit angazhohet që punët të shkojnë mirë. Gjatë fillimit të këtij viti janë të shumtë dëgjuesit, të cilët tashmë të gëzuar për atë çfarë Hyji po dhuron në familjet e tyre, vazhdojnë që këtë gëzim të mos e mbajnë vetëm për vete, por po e përcjellin dhe tek të tjerët, tek të afërmit, tek miqtë dhe të njohurit e tyre kudo që ndodhen. Ata me gëzim në zemer flasin për të mirat shpirtërore që Hyji nëpërmjet Radio Marisë po sjell në jetën e tyre, u tregojnë atyre frekuencat, numrat e telefonit dhe programin. Janë të shumtë dëgjuesit të cilët i sjellin në Radio Mari të afërmit e tyre, dëgjuesit e rinj për t'i njohur me Radion dhe stafin e saj. Gjithashtu janë shtuar në numër përfaqësuesit e Radios në vende të ndryshme. Ata e quajnë veten fatlumë që u është dhënë mundësia të vihen në shërbim të Radio Marisë. Ata thonë se- "Duke i shërbyer Radio Marisë ne jemi venë në shërbim të vetë Hyjit, pasi Radio Maria është në të mirën shpirtërore të gjithë atyre që e dëgjojnë". Si rrjedhojë e lutjeve dhe e punës vazhdon të jetë në rritje numri i suksesëve të Radio Marisë dhe për këtë ne e falënderojmë Hyjin. **Roza**



### MIQ NË ZVICËR

NDIHMONI në Nr. e llogarisë:

**CREDIT SUISSE**

**RADIO MARIA IBAN:**

CH18 0483 5036 1173 1000 1

**KONTO 361173-10-1**

**Faleminderit për ndihmën tuaj!**



## Këndi i fëmijëve

### KONKURSI

Ditën e shtunë me dt. 07 shkurt 2009, u zhvillua konkursi i emisionit të fëmijëve. Të pranishëm në studio qenë dy fëmijë: Emanueli dhe Renato nga Vau i Dejës. Me Emanuelin jemi njohur që në konkursin e parë, por me Renaton jo. Prandaj edhe gjatë emisionit u zhvilluan pyetje mbi njohjen e tij për Radio Marinë si p.sh: Kur je njohur herë e parë me Radio Marinë? Kush të ka shtyrë që të telefonoje në emisionin e fëmijëve etj. Pyetjet e konkursit u drejtuan në bazë të pjesëve të marra nga libri i përhershëm "Historia e Kishës". Dy ishin rubrikat kryesore në këtë konkurs të muajit janar, rubrika "Përgjigju pyetjes" dhe rubrika "E saktë apo e gabuar". Pyetjet e rubrikës "Përgjigju pyetjes" u drejtuan Emanuelit ndërsa pyetjet e rubrikës "E saktë apo e gabuar" u drejtuan Renatos pasi u ra dakort më parë me to. Kjo ishte edhe struktura e konkursit të dashur lexues dhe sigurisht në të ishin të përfshirë edhe këngët e zgjedhura nga vetë Emanueli dhe Renato. Pak a shumë kjo ishte edhe përmbledhja në të cilën është zhvilluar konkursi. **Izabela Marku**



## Një përvojë e jashtëzakonshme!!!

Përpara disa kohëve, një ditë gjatë pushimeve verore, duke degjuar disa këngë në radio, padashur lëvizja diçka dhe me doli një radio që se kisha degjuar kurrë më parë. Nga kureshtja fillova ta dëgjoja gjithë ditën. Ajo ishte Radio Maria. Aq shumë la mbresa në shpirtin tim sa që çdo ditë e degjoja dhe merrja pjesë edhe në emisionin e fëmijëve. Kështu vazhdoi për një vit me radhë. Ai ishte viti më i lumtur i jetës sime. Pas një viti për disa arsye familjare m'u desh të vija të banoja në Shkoder. Pasi e dija që Radio Maria ishte në Shkoder, më lindi ideja që të shkoja e të shihja si ishte radioja. Dhe ajo nuk ishte një dëshirë që nuk do të realizohej kurrë, sepse ajo u bë realitet. Kur shkova për herë të parë atje nuk po u besoja syve, por ja që ishte e vërtetë, takova Orselinën, një vullnetare të Radio Marisë. Biseduam së bashku dhe në fund më tha që mund të vija dhe të bëhesha pjesë e radios. Më pushtuan emocione të pafundme. Javen tjetër shkova për herë të parë në takim me vullnetarët e radios. Kisha shumë emocione. Me vinte shumë turp, por turpi më iku pas disa çastesh sepse të gjithë filluan të prezantoheshin me mua. Kështu edhe sot vazhdoj të jem një vullnetare ose një pjesë e Radio Marisë. Dikur isha vetëm një dëgjuese, por sot jam një pjesë e saj dhe Radio Maria është me të vërtetë një hap përpara në jetën time. Falënderoj Zotin dhe Nënë Qiellore që më dha mundësinë të jem kjo që jam tani dhe falënderoj shumë edhe Don Prekën dhe të gjithë vullnetarët e Radio Marisë për të gjithë respektin dhe dashurinë që më kanë dhuruar mua dhe çdo bashkëpunatori dhe dëgjuesi.

**Brikena Pllumbaj**



Prishtinë, 23.02.2009

I nderuari zotëri Don Prekë,

Nga se asnjëherë deri më tani nuk kemi pasur rastin të komunikojmë në këtë mënyrë, sigurisht se kjo letër imja do t' u befasojë në fillim. Dhe, unë, pajohem se është një befasia, por një befasia e mirë.

Shkaku që po Ju shkruaj është libri "Pali i Tarsit vigani i Krishterimit", të cilin e përfundova së lexuari vetëm para pak minutash, dhe nuk munda të mos

Ju shkruaj dhe t' Ju përgëzoj.

Jam tepër i kënaqur që pata rastin ta lexoj një libër të tillë.

E di edhe ti, se unë kam lexuar dhe vazhdoj të lexoj literaturë të zhanreve të ndryshme dhe kam një përvojë në "artin e të lexuarit". Kam një përgatitje relativisht të mirë në vlerësimin e asaj që e lexoj.

Por, "arti i përkthimit" të këtij libri nga ana Juaj, jo vetëm që më ka befasuar, por edhe më ka mahnitë. Gjatë leximit të kujdesshëm të këtij libri, lexuesi sikur fiton përshtypjen se i tëri është shkruar shqip nga autori. Është një përkthim që dëshmon për:

- njohjen në thellësi, nga ana juaj, e lëndës që trajton autori i librit;
- informatat deri në detaje të "gjeografisë së lëvizjes" se Palit të Tarsit, sikur të kishit qenë bashkëkohnik, bashkëemisionar dhe bashkëveprimtar i tij;
- njohjen solide të gjuhës nga e cila përktheni dhe të gjuhës në të cilën përkthehet libri.

Jam shumë i lumtur që keni arritur këtë nivel, mburrem me punën që keni bërë.

Ju falënderoj për kënaqësinë që m' a dhatë gjatë leximit të një teksti solid në gjuhën shqipe. Uroj që të mos ndaleni me kaq dhe ngrohtësisht Ju përshëndet,

**Kolë M. Berisha**

**NË RADIO MARI KENI MUNDËSI TA  
GJENI LIBRIN:**

**“PALI I TARSIT-VIGANI  
I KRISHTERIMIT”**

**Një javë në Gjakovë**

Që nga data 08.02.2009 – 16.02.2009 janë ditë në të cilat iu kemi përkushtuar formimit të vullnetarëve të Radio Marisë në Kosovë, në studion së saj në Gjakovë.

Në këto ditë është punuar për veshjen e studios, sistemi i aparaturave, aktivizimi i kompjuterit, tavolina e studios gjërat

më të domosdoshme që nevojiten për momentin në studio. Këto janë gjërat bazë të punës fizike, materiale. Ndërsa një tjetër aspekt i domosdoshëm që është bërë gjatë këtyre ditëve nga Don Preka ishte takimi i vazhdueshëm me njerëzit, me dëgjuesit, me të rinj e të reja, me mosha të thyeme me fëmijë, me meshtarë. Në Gjakovë dhe në vende të tjera. Është folur për përhapjen e radios, dëgjueshmërinë, si duhet të bëhet e pranishme edhe tek të tjerët. Këto takime ishin si moment promovimi për radion, mënyrën se si mund të ndihmohet radioja. Në një vizitë në të cilën ishim në një familje në të cilën ishin vetëm burrë dhe grua të moshuar, 80, 75 vjeç të cilët e ndihmojnë radion gjatë bisedës na tha: «Nuk nuk kam përjetuar gëzim më të madh dhe nuk kam marrë nderë e dhuratë më të madhe se vizitën tuaj në shtëpinë time».

Pastaj ditën e premte është bërë një takim me disa vullnetarë të radios disa që momentalisht e japin aq sa munden kontributin e tyre në radio në emisionin e të mërkurës ishin në takim Don Preka, P. Lorenci, P. Ndou, M. Lindita, M. Simona, Elizabeta Nushi, Alban Nushi, Mimoza Raja, Merita Raja, Anton Komani, Nikoll Bibaj, Orselina. Në këtë takim së pari Don Preka bëri një paraqitje të radios, ecurinë, rëndësinë e të qenurit vullnetarë, çfarë do të thotë të punosh në radio, angazhimi që merret etj... Gjatë bisedës së lirë kishte edhe pyetje nga të pranishmit si ka lindur RM në botë, në Shqipëri, a ka pas dhe a ka vështirësi, çfarë mund të kontribuojmë ne, diskutim mi emisionet pyetje, etj... **Orselina**



**Lutja për Radio Marië**

**O Zojë, drejtoji zgjidhjet tona jetësore. Na mbështet në orën e provës që me besnikëri ndaj Hyjit dhe njerëzve ta përballojmë me guxim të përvuajtur misterin e eterit që të arrjmë mendjen dhe zemrën e secilit person me shpallje të gëzueshme të Krishtit, Shpëtimtarit të njeriut. O Mari, yll i ungjillëzimit, ec së bashku me ne. Drejtoje Radio Marinë dhe ji pajtorja e saj. Amen.**

**Radio Maria Shqiptare**  
"Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde"

### FREKUENCAT E RADIO MARISË

Në Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat:

FM 91.4 MHz;

Në Shkodër, Podgoricë, Ulqin:

FM 102.2 MHz;

Në Lezhë, Laç të Kurbinut, Mamurras:

FM 89.6 MHz;

Në Pukë, Fushë Arrës, Tropojë, Kukës

dhe Kosovë: FM 90.0 MHz;

Në Internet:

www.radiomaria.org.al

## MIQË TË RADIO MARISË

Më 25 Mars 2009 Ditën e Lajmërimit të Zotit, Imzot Rrok Mirdita Arqipeshkvi Metropolit Tiranë Durrës dhe Presidenti i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, në Tiranë do ta bekojë gurin e themelit të ndërtesës së re të Radio Marisë.

Zoja e bekuar, Nëna jonë e ka rezervuar një vend të veçantë për ty, të pret që edhe ti të vish për të dhen dëshminë për dashurinë që ka për popullin tonë. Mos harro:

**MË 25 MARS 2009**

**Ditën e Lajmërimit të Zotit**

**Bekohet guri i themelit të ndërtesës së Radio Marisë.**

**Eja në këtë festë të madhe**

**«Lajmëtari i Radio Marisë» është organ i «Shoqatës Radio Maria»**

**Rr. 4 Dëshmorët Nr. 48 Tiranë ALBANIA**

**Telefon: Tiranë: 00355 42260466 Shkodër: 00355 22241808**

**Pergjegjës: Don Prekë Lazraj**

### Si të jemi mirënjohës

Të dashur miq, koha e kreshmëve është koha e lutjes pendesës dhe lëshohës. Tashmë je i vetëdijshëm se Radio Maria ka nevojë të madhe për lutjen dhe pendesën tënde.

Po fillojmë ndërtimin e selisë së Radio Marisë në Tiranë. Ky është rasti që për ndërtimin e këtij objekti të rëndësishëm që do të përhap fjalën e Zotit dhe dashurinë e tij, të japësh edhe ti lëshohës tënde. Zoti nuk kërkon as pak as shumë prej asnjërit prej nesh, beje atë që ke mundësi për përhapjen e Fjalës dhe të dashurisë së Zoti në popullin Shqiptar. Nga varfëria jote ke mundësi të japësh një gurë në ndërtimin e ndërtesës së Radio Marisë. Ju falënderojmë!

**Çdo ditë në orën 21, Lute Kruzaren e Zojës së bashku me të gjithë familjarët e tu dhe me mbarë familjen e Radio Marisë!**

### Lurdi 1058 – 2008

Bërnardeta thotë: «Zoja më shikonte si një person që flet më një person tjetër». Në këtë bashkëbisedim, në këtë dialog të cilin e përfshinte plotësisht butësia, Zoja e ngarkoi të transmetonte porosinë e ndryshme shumë të thjeshta për lutjen, për pendesën dhe kthimin. Nuk është kurrfarë mrekullie që Maria është e bukur, sepse, në shfaqjen e 25 marsit 1858, ajo zbulon emrin e saj kështu: «Unë jam Të Zënët e Pamëkat».



### Viti i Shën Palit

29.06.2008 – 29.06.2009

#### Ati i shenjtë na flet

Pali, mësuesi ynë  
Mësuesi i popujve, apostulli dhe flamurtari i Jezu Krishtit, kështu e karakterizon Pali veprimtarinë e vet të kaluar. Mirëpo «Apostulli i popujve» - hapet edhe përpara së ardhmes, para të gjithë popujve dhe të gjitha breznive. Pali për ne nuk është një figurë e të kaluarës, të cilën e kujtojmë me nderim. Ai është edhe mësuesi ynë, apostull dhe flamurtar i Jezu Krishtit edhe për ne.

**NDIHMONI RADIO MARINË NË:**

**BANKA INTESA SANPAOLO**

**LLOG LEKË: 1043631801**

**LLOG EURO: 1043631803**

**PRO-CREDITBANK SHKODËR:**

**LLOG LEKË: 600388970001**

**LLOG EURO: 600388970102**

**PRO-CREDIT TIRANË:**

**LLOG LEKË: 127837030101**

**LLOG EURO: 127837030002**